



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.158 dt.06.11.1998

**“PER PRIVATIZIMIN E DISA AMBIENTEVE TE REPARTIT INSPEKTIM
SHPETIM MINIERA LAPRAKE TE KALUARA NE FOND BANESE
ME V.K.B. NR.167, DT.10.10.1996”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.06.11.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit) “Propozim për privatizimin e disa ambienteve të kaluara në fond banese dhe akoma të pa privatizuara”, duke u mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.167, dt.10.10.1996 për kalimin e tyre në fond banese dhe bazuar në Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440, dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore akoma të pa privatizuara” si dhe në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”

V E N D O S I

1. Ambientet prej dy dhomave pranë poligonit të stërvitjes të Repartit Shpëtim Miniera në Laprakë për të cilën është paisur me autorizim definitiv qytetari Avni Askurti të privatizohet si banesë e kategorisë së tretë.
2. Dy ambientet me nga tre dhoma e banjë si dhe ambientit prej një dhomë e banjë pranë sallës së gadishmërisë se po këtij repartit për të cilat janë pajisur me autorizime definitive qytetarët :

- Yllka Kallajxhi (2+1) dhe banjë
- Mustafa Ahmeti (2+1) dhe banjë
- Ardian Kullolli një dhomë e banjë

Të privatizohen si banesa të kategorisë së tretë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI